



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:255015

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05612258

Ac.nr.9300/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Lumni Sallauka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B..... S....., H..... S....., M..... S....., E..... S..... dhe R..... S....., të cilët i përfaqëson Avokati E..... A..... nga Prishtina, kundër të Paditurës Komuna e Prishtinës, të cilën e përfaqëson Avokatura “I.....” Sh.p.k, për shkak të vërtetimit të të drejtës së pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së palëve ndërgjyqëse të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2683/13, të datës 22.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prishtinës, **NDRYSHOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2683/13, i datës 22.04.2021, përkatësisht dispozitivi I dhe III, dhe çështja lëndore gjykohet si në vijim: **REFUZOHET në tërësi si e pathemeltë** kërkesëpadia e paditësve B..... S....., H..... S....., M..... S....., E..... S..... dhe R..... S....., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, përmes së cilës kanë kërkuar që të **VËRTETOHET** se paditësit janë pronar si vijon:

Paditësi **B..... S.....** nga Prishtina: në pjesën e njësisë kadastrale nr.2620-1 me kulturë arë e klasit të katërt në vendin e quajtur “Gropa e Madhe” në sipërfaqe prej 200 m² e regjistruar në certifikatën për njësi kadastrale P-71914059-02620-1 Z.K Prishtinë, me këto matje dhe përkufizime gjeodezike:

- Nga pika 6 deri në pikën 7, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 3.25 m,
- Nga pika 7 deri në pikën 8, kufiri është i drejtë gjatësia e frontit është 9.33 m,
- Nga pika 8 deri në pikën 9, kufiri është i drejtë gjatësia e frontit është 5.61 m,
- Nga pika 9 deri në pikën 10, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 12.12 m,
- Nga pika 10 deri në pikën 21, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 12.01 m,
- Nga pika 21 deri në pikën 6, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 15.43 m.

Paditësi **M..... S.....** nga Prishtina: në pjesën e njësisë kadastrale nr.2620-1 me kulturë arë e klasit të katërt në vendin e quajtur “Gropa e Madhe” në sipërfaqe prej 249 m² e regjistruar

në certifikatën për njësi kadastrale P-71914059-202620-1 Z.K Prishtinë, me këto matje dhe përkufizime gjeodezike:

- Nga pika 10 deri në pikën 11, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 13.63 m,
- Nga pika 11 deri në pikën 12, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 9.69 m,
- Nga pika 12 deri në pikën 13, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 0.21 m,
- Nga pika 13 deri në pikën 20, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 10.44 m,
- Nga pika 20 deri në pikën 19, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 2.75 m,
- Nga pika 19 deri në pikën 18, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 0.52 m,
- Nga pika 18 deri në pikën 17, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 4.73 m,
- Nga pika 17 deri në pikën 5, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 17.48 m,
- Nga pika 5 deri në pikën 6, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 6.04 m,
- Nga pika 6 deri në pikën 21, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 15.43 m,
- Nga pika 21 deri në pikën 10, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 12.01 m.

Paditësi **E..... S.....** nga Prishtina: në pjesën e njësisë kadastrale nr.2620-1 me kulturë arë e klasit të katërt, në vendin e quajtur “Gropa e Madhe” ne sipërfaqe prej 249 m² e regjistruar në certifikatën për njësi kadastrale P-71914069-026201-1 Z.K Prishtinë, me këto matje dhe përkufizime gjeodezike:

- Nga pika 4 deri në pikën 5, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 6.70 m,
- Nga pika 5 deri në pikën 17, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 17.48 m,
- Nga pika 17 deri në pikën 18, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 4.73 m,
- Nga pika 18 deri në pikën 19, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 0.52 m,
- Nga pika 19 deri në pikën 20, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 2.75 m,
- Nga pika 20 deri në pikën 13, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.44 m,
- Nga pika 13 deri në pikën 14, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 12.82 m,
- Nga pika 14 deri në pikën 15, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.32 m,
- Nga pika 15 deri në pikën 16, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 1.48 m,
- Nga pika 16 deri në pikën 4, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 16.48 m.

Paditësi **H..... S.....** nga Prishtina: në pjesën e ngastrës kadastrale 2620-1 me kulturë arë e klasit të katërt në vendin e quajtur “Gropa e Madhe” në sipërfaqe prej 71 m², Z.K Prishtinë me këto matje dhe përkufizime gjeodezike:

- Nga pika 3 deri në pikën 4, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 3.99 m,
- Nga pika 4 deri në pikën 16, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 16.48 m,
- Nga pika 16 deri në pikën 2, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 4.85 m,
- Nga pika 2 deri në pikën 3, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 15.95 m.

Paditësi **R..... S.....** nga Prishtina: në pjesën e njësisë kadastrale nr.2620-1 me kulturë arë e klasës së katërt në vendin e quajtur “Gropa e Madhe” në sipërfaqe prej 70 m² Z.K Prishtinë me këto matje dhe përkufizime gjeodezike:

- Nga pika 1 deri në pikën 2, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.09 m,
- Nga pika 2 deri në pikën 16, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 4.85 m,
- Nga pika 16 deri në pikën 15, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 1.48 m,
- Nga pika 15 deri në pikën 14, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.32 m,

- Nga pika 14 deri në pikën 1, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 7.30 m.

II. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësve H..... dhe R..... S.... nga Prishtina, ndërsa Aktgjykimi C.nr.2683/13, i datës 22.04.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, përkatësisht dispozitivi II, që ka të bëjë me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve, kundër të paditurës, përmes së cilës kanë kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe atë si vijon:

Paditësit **H..... S.....** nga Prishtina i refuzohet kërkesëpadia për pjesën e ngastrës kadastrale nr.2997-4 me kulturë Rrugë, në vendin e quajtur “Përroi i Thatë” në sipërfaqe prej 176 m² Z.K Prishtinë, me këto matje dhe përkufizime gjeodezike:

- Nga pika 25 deri në pikën 26, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.51m,
- Nga pika 26 deri në pikën 27, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 5.52 m,
- Nga pika 27 deri në pikën 3, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 9.34 m,
- Nga pika 3 deri në pikën 2, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 15.95 m,
- Nga pika 2 deri në pikën 15, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 12.02 m, dhe

Paditësit **R..... S.....** nga Prishtina i refuzohet Kërkesëpadia për pjesën e ngastrës kadastrale nr.2997-4 me kulturë Rrugë, në vendin e quajtur “Përroi i Thatë” në sipërfaqe prej 114 m² Z.K Prishtinë, me këto matje dhe përkufizime gjeodezike:

- Nga pika 24 deri në pikën 25, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.87 m,
- Nga pika 25 deri në pikën 2, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 12.02 m,
- Nga pika 2 deri në pikën 1, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.09 m,
- Nga pika 1 deri në pikën 24, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 9.90 m,

VËRTETOHET.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar ka vendosur në këtë mënyrë: **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar Kërkesëpadia e Paditësve B..... S....., H.... S....., M..... S....., E..... S..... dhe R..... S....., të gjithë nga Prishtina si e bazuar dhe vërtetohet se Paditësit e kanë fituar të drejtën e pronësisë individuale në paluajtshmërinë si vijon:

1. Paditësi **B..... S.....** nga Prishtina: në pjesën e njësisë kadastrale nr.2620-1 me kulturë arë e klasit të katërt në vendin e quajtur “Gropa e Madhe” në sipërfaqe prej 200 m² e regjistruar në certifikatën për njësi kadastrale P-71914059-02620-1 Z.K Prishtinë, me këto matje dhe përkufizime gjeodezike:
 - Nga pika 6 deri në pikën 7, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 3.25 m,
 - Nga pika 7 deri në pikën 8, kufiri është i drejtë gjatësia e frontit është 9.33 m,
 - Nga pika 8 deri në pikën 9, kufiri është i drejtë gjatësia e frontit është 5.61 m,
 - Nga pika 9 deri në pikën 10, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 12.12 m,
 - Nga pika 10 deri në pikën 21, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 12.01 m,
 - Nga pika 21 deri në pikën 6, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 15.43 m.

2. Padiësi **M..... S.....** nga Prishtina: në pjesën e njësisë kadastrale nr.2620-1 me kulturë arë e klasit të katërt në vendin e quajtur “Gropa e Madhe” në sipërfaqe prej 249 m² e regjistruar në certifikatën për njësi kadastrale P-71914059-202620-1 Z.K Prishtinë, me këto matje dhe përkufizime gjeodezike:
- Nga pika 10 deri në pikën 11, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 13.63 m,
 - Nga pika 11 deri në pikën 12, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 9.69 m,
 - Nga pika 12 deri në pikën 13, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 0.21 m,
 - Nga pika 13 deri në pikën 20, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 10.44 m,
 - Nga pika 20 deri në pikën 19, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 2.75 m,
 - Nga pika 19 deri në pikën 18, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 0.52 m,
 - Nga pika 18 deri në pikën 17, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 4.73 m,
 - Nga pika 17 deri në pikën 5, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 17.48 m,
 - Nga pika 5 deri në pikën 6, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 6.04 m,
 - Nga pika 6 deri në pikën 21, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 15.43 m,
 - Nga pika 21 deri në pikën 10, kufiri është i drejtë, gjatësia e frontit është 12.01 m.
3. Padiësi **E..... S.....** nga Prishtina: në pjesën e njësisë kadastrale nr.2620-1 me kulturë arë e klasit të katërt, në vendin e quajtur “Gropa e Madhe” në sipërfaqe prej 249 m² e regjistruar në certifikatën për njësi kadastrale P-71914069-026201-1 Z.K Prishtinë, me këto matje dhe përkufizime gjeodezike:
- Nga pika 4 deri në pikën 5, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 6.70 m,
 - Nga pika 5 deri në pikën 17, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 17.48 m,
 - Nga pika 17 deri në pikën 18, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 4.73 m,
 - Nga pika 18 deri në pikën 19, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 0.52 m,
 - Nga pika 19 deri në pikën 20, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 2.75 m,
 - Nga pika 20 deri në pikën 13, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.44 m,
 - Nga pika 13 deri në pikën 14, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 12.82 m,
 - Nga pika 14 deri në pikën 15, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.32 m,
 - Nga pika 15 deri në pikën 16, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 1.48 m,
 - Nga pika 16 deri në pikën 4, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 16.48 m.
4. Padiësi **H..... S.....** nga Prishtina: në pjesën e ngastrës kadastrale 2620-1 me kulturë arë e klasit të katërt në vendin e quajtur “Gropa e Madhe” në sipërfaqe prej 71 m², Z.K Prishtinë me këto matje dhe përkufizime gjeodezike:
- Nga pika 3 deri në pikën 4, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 3.99 m,
 - Nga pika 4 deri në pikën 16, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 16.48 m,
 - Nga pika 16 deri në pikën 2, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 4.85 m,
 - Nga pika 2 deri në pikën 3, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 15.95 m.
5. Padiësi **R..... S.....** nga Prishtina: në pjesën e njësisë kadastrale nr.2620-1 me kulturë arë e klasës së katërt në vendin e quajtur “Gropa e Madhe” në sipërfaqe prej 70 m² Z.K Prishtinë me këto matje dhe përkufizime gjeodezike:
- Nga pika 1 deri në pikën 2, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.09 m,
 - Nga pika 2 deri në pikën 16, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 4.85 m,

- Nga pika 16 deri në pikën 15, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 1.48 m,
- Nga pika 15 deri në pikën 14, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.32 m,
- Nga pika 14 deri në pikën 1, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 7.30 m.

I. REFUZOHET Kërkesëpadia e Paditësve H..... S..... nga Prishtina dhe R..... S..... nga Prishtina si e pa bazuar me të cilën kanë kërkuar që ti njihet e drejta e pronësisë në patundshmëritë si në vijim:

Paditësit H..... S..... nga Prishtina i refuzohet kërkesëpadia për pjesën e ngastrës kadastrale nr.2997-4 me kulturë Rrugë, në vendin e quajtur “Përroi i Thatë” në sipërfaqe prej 176 m² Z.K Prishtinë, me këto matje dhe përkufizime gjeodezike:

- Nga pika 25 deri në pikën 26, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.51m,
- Nga pika 26 deri në pikën 27, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 5.52 m,
- Nga pika 27 deri në pikën 3, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 9.34 m,
- Nga pika 3 deri në pikën 2, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 15.95 m,
- Nga pika 2 deri në pikën 15, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 12.02 m, dhe

Paditësit R..... S..... nga Prishtina i refuzohet Kërkesëpadia për pjesën e ngastrës kadastrale nr.2997-4 me kulturë Rrugë, në vendin e quajtur “Përroi i Thatë” në sipërfaqe prej 114 m² Z.K Prishtinë, me këto matje dhe përkufizime gjeodezike:

- Nga pika 24 deri në pikën 25, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.87 m,
- Nga pika 25 deri në pikën 2, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 12.02 m,
- Nga pika 2 deri në pikën 1, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.09 m,
- Nga pika 1 deri në pikën 24, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 9.90 m.

II. OBLIGOHET e Paditura Komuna e Prishtinës që Paditësve si në pikën I. të dispozitivit të këtij Aktgjykimi ti DUROI dhe LEJOJË Paditësit që Pjesët e Paluajtshmërive e cekura si në pikën I. pikat 1), 2), 3), 4) dhe 5) ti bartin dhe ti regjistrojnë në regjistrat e paluajtshmërive në pronësi të tyre individuale. Ky Aktgjykim do të shërbej si bazë juridike për regjistrimin e patundshmërive si në pikën I të dispozitivit në Aparatin Kadastral të Komunës së Prishtinës.

III. Obligohet e Paditura Komuna e Prishtinës që Palës Paditëse të ia kompensoi shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 5.057,00 (Pesëmijë e pesëdhjetë e shtatë) Euro, e të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij Aktgjykimi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, për shkak të shkeljes qenësore të dispozitave të rocedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës material, me propozim që të ndryshohet Aktgjykimi i atakuar në dispozitivin II dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësve H..... dhe R..... S....., apo i njejtë të prishet dhe kjo pjesë të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve së dispozitave të procedurës civile, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes

faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale si dhe për shkak të vendimit mbi shpenzimet e procedurës, me të cilën ka propozuar që Gjykata e Apelit ta ndryshoj Aktgjykimin e atakuar duke refuzuar ë tërësi kërkesëpadinë e paditësve, apo të njejtin ta prish dhe ta kthen në rigjykim dhe rivendosje këtë çështje kontestimore.

Përgjigje në ankesën e të paditurës, kanë paraashtruar paditësit, me propozim që të vërtetohet Aktgjykimi i atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësve është e pa themeltë, ndërsa e të paditurës është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit me datë 10.10.2013, kundër të paditës ka parashtruar padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të parashkrimit fitues dhe shitblerjes.

Gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka mbajtur seancën përgaditore dhe atë kryesore dhe ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e Aktgjykimit të atakuar ndër të tjera theksohet se:

Nga dëshmia e vdekjes e lëshuar nga Komuna e Prishtinës me datën 19.08.2019 vërtetohet se tani i ndjeri S..... H..... S..... i lindur më datën 05.05.1922 në A....., Komuna e Lipjanit, kishte vdekur me datën 17.11.1968 në Prishtinë dhe nga trashëgimtarët ligjor të shënuar në aktvdekje vërtetohet se i njejtë ka lënë trashëgimtarët B..... S..... H..... S....., M..... S....., E..... S..... dhe R..... S..... Ky fakt vërtetohet edhe përmes certifikatave të lindjes së trashëgimtarëve të sipër cituar të cilët certifikata të lindjes i janë bashkangjitur aktit të vdekjes dhe vërtetohet se të gjithë Paditësit janë fëmijët e tani të ndjerit S..... (H.....) S..... Prandaj përmes këtyre provave vërtetohet në tërësi se ekziston legjitimiteti aktiv për të qenë palë në këtë çështje procedurale.

Nga Kontrata për shitblerje e datës 17.05.1992 figuron se e njëjta Kontratë është lidhur me datën 17.05.1972 nga F..... (B.....) Osmani nga Prishtina si shitës dhe S..... (H.....) S..... nga fshati A....., Komuna e Lipjanit dhe atë për shitjen e një sipërfaqe toke prej 0.09.00 ha për çmimin kontraktues prej 43.500,00 EURO. Kjo Kontratë interne nuk i është prezantuar Gjykatës në origjinal por është vetëm fotokopje, nënshkrimi për shitësin F..... O..... në kontratën fotokopje është në çirilicë, ndërsa nënshkrimi në pjesën e S..... (H.....) S..... është gati i pa lexueshëm. Duke marrë parasysh se kjo Kontratë është fotokopje, nuk është legalizuar në Gjykatë dhe nuk është prezantuar asnjëherë në origjinal, Gjykata të njëjtës nuk ia fali besimin dhe nuk e vlerësoi me relevancë për objektin e kontestit. Aq më tepër kur Përfaqësuesi i Palës Paditëse ,në Padinë e tij nuk i ka përfshirë edhe F..... (B.....) O..... apo nëse i njëjti është i

vdekur trashëgimtarët e tij për të provuar konvalidimin e kësaj Kontrate, pra vetë fakti se F..... (B.....) O..... e as ndonjë trashëgimtar i tij nuk është përfshirë në Padi me qëllim të konvalidimit eventual të kësaj kontrate e po ashtu nuk është propozuar dhe dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve kanë qenë vendimtare që Gjykata kësaj prove të mos ia fal besimin.

Nga Aktvendimi numër 07.nr.465-25/85 i datës 08.07.1985, Sekretariati për Financa i Kuvendit të Komunës së Prishtinës kishte nxjerrë Aktvendim me të cilin i kishte eksproprijuar dhe bartur në favor të Komunës së Prishtinës për nevoja të BVI-së për qeverisjen e tokave ndërtimore në Prishtinë, prona e patundshme e qytetarëve në Kuvendin Komunal të Prishtinës dhe Kuvendin Komunal të Matiçanit për ndërtimin e vendbanimit “Kodra e Diellit 2” në Prishtinë ku në pikën 3 të Dispozitivit të këtij Aktvendimi faqe 2 ishte përfshirë edhe prona e F..... (B.....) O..... nga Prishtina, adresa ish “A... M.....” numër 19, toka e regjistruar në listën posedues numër 240 e shënuar si parcele kadastrale nr. 2620 arë e klasit të katërt me sipërfaqe prej 0.92.21 ha. Në faqen 6 të këtij Vendimi, në pasuesin e parafundit përshkruhen lista e pronarëve të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e dëgjimit publik, ndërsa në pasuesin e fundit ka konstatuar se ftesës nuk i janë përgjigjur H..... (V.....) D..... nga Prishtina, F..... C..... dhe T..... C..... nga Prishtina, H..... G..... nga Prishtina, F..... (O.....) A..... dhe Z..... H..... nga Prishtina. Në krahasimin e dispozitivit dhe arsytimit të Aktvendimit ekziston një kontradiktoritet shumë i madh sepse në pikën 3 të dispozitivit patundshmëria e F..... (B.....) O..... ishte përfshire në eksproprijim ndërsa në arsytimin e këtij Aktvendimi ishin ftuar të gjithë pronaret e përshkruar në faqen 6 të Aktvendimit, por nuk ishte përshkruar edhe F..... (B.....) O..... Prandaj për Gjykatën është e besueshme se përderisa nuk është ftuar në diskutim publik F..... (B.....) O..... të njëjtit mund edhe të mos i jetë dorëzuar fare kopja e Aktvendimit mbi eksproprijimin dhe i njejtë mund të mos ketë qenë në dijeni të ekzistimit të një Aktvendimi të tillë, prandaj edhe i njejtë nuk ka mundur që të i ushtrojë mjetet juridike kundër një Aktvendimi përderisa nuk është ftuar në diskutim publik dhe përderisa e Paditura Komuna e Prishtinës në Përgjigjen në Padi dhe në shqyrtimet e seancave gjyqësore nuk ka pretenduar një gjë të tillë.

Aq më tepër kur ky vendim është nxjerrë në vitin 1985, sipas ekspertizës së Ekspertit të gjeodezisë të cilën do ta vlerësojmë në pikat vijuese të arsytimit rezulton se në patundshmërinë lëndore ka pasur objekte të ndërtuara nga Paditësit qysh në vitin 1979 dhe kjo vërtetohet përmes matjeve të aerofotogrametrisë të vitit 1983, pra organi shpronësues përpos që nuk e ka ftuar në diskutim publik F..... (B.....) O....., i njëjti nuk i ka identifikuar dhe nuk i ka ftuar në diskutim publik edhe Palën Paditëse. Përfaqësuesi i Palës Paditëse lidhur me Aktvendimin mbi eksproprijimin ka ngritur këto pretendime dhe atë: 1) Pretendimi i parë është se Aktvendimi mbi eksproprijimin nuk e ka arritur qëllimin e eksproprijimit asnjëherë, gjegjësisht nuk është bërë ndërtimi i vendbanimit “Kodra e Diellit 2” në Prishtinë, 2) Paditësit si posedues faktik të patundshmërisë lëndore nuk janë de poseduar asnjëherë e as personi F..... (B.....) O..... si pronarë juridik në kohën kur është nxjerrë aktvendimi nuk është deposeduar asnjëherë, 3) Çmimi për pasurinë e eksproprijuar nuk i është paguar pronarit juridik F..... O..... e as poseduesve apo pronarëve faktik tani Paditësve asnjëherë. Pra, këto kishin qenë pretendimet e Padisë, ndërsa pretendimet e të Paditurës kishin qenë se me nenin 21 paragrafi 5 i Ligjit mbi Eksproprijimin parashihet se pasi që të kalojë afati prej 10 viteve nga koha kur vendimi mbi eksproprijimin të marrë formën e prerë nuk mund të kërkohet de eksproprijimi, dhe pretendimi tjetër kishte qenë

se me nenin 29 të Ligjit për marrëdhëniet themelore pronësore juridike LMPHJ përcaktohet se në sendin në pronësi shoqërore nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues.

Lidhur me pretendimin e parë të përfaqësuesve të Paditësve se qëllimi i eksproprijimit nuk është arritur asnjëherë, Gjykata u bind dhe ia fali besimin për shkak të faktit se në patundshmërinë lëndore nuk ishin ndërtuar ndërtesat kolektive të banimit në kompleksin e paraparë “Kodra e Diellit II”, për shkak se në patundshmërinë lëndore, Paditësit kishin ndërtuar shtëpia banimi me materiale të forta dhe objekte tjera përcjellëse, Gjykata u bind se as Paditësit si shfrytëzues faktik nuk ishin de poseduar e as F..... (B.....) O.... si pronar juridik nuk ishte de poseduar, prandaj Gjykata ia fali besimin edhe këtij pretendimi. Lidhur me pretendimin e tretë se Paditësve asnjëherë nuk iu është kompensuar patundshmëria e eksproprijuar dhe se pronarit juridik F..... (B.....) O..... nuk i ishte kompensuar patundshmëria e eksproprijuar, Gjykata ia fali besimin edhe këtij pretendimi për arsyet si në vijim: vete e paditura Komuna e Prishtinës nuk kishte ofruar prova se kjo patundshmëri ishte kompensuar qoftë pronarit juridik F..... (B.....) O..... apo poseduesve të cilët tani janë në cilësinë e Paditësve, përveç se komuna nuk kishte ofruar prova lidhur me kompensimin e kësaj patundshmërie, e paditura Komuna e Prishtinës nuk ishte ngritur as pretendime se kjo patundshmëri ishte kompensuar qoftë F.... (B.....) O..... apo tani Paditësve, pra Komuna nuk kishte pretenduar një gjë të tillë. Ndërsa vetë fakti se në faqen 6 pasuesi i fundit i arsyetimit të Aktvendimit mbi eksproprijimin figuron se janë ftuar të gjithë pronarët e përshkruar si në arsyetim, por nuk është ftuar edhe pronari F..... (B.....) O..... apo poseduesit të cilët tani janë në cilësinë e Paditësve, e kanë bindur Gjykatën se të njëjtëve nuk i është kompensuar asnjëherë patundshmëria sipas këtij Aktvendimi dhe se për Gjykatën mbetet e pa çarte a iu ka dorëzuar ndonjëherë ky Aktvendim pronarit juridik F..... (B.....) O..... apo tani Paditësve të cilët kishin qenë në posedim të patundshmërisë lëndore edhe përpara se të nxirret Aktvendimi mbi eksproprijimin. Prandaj Aktvendimi mbi eksproprijimin ka mundur të bëhet i formës së prerë ndaj pronarëve tjerë por i njëjti nuk ka mundur të bëhet i formës prere për pikën 3 të Dispozitivit përderisa nuk ka prova se i njëjti është ftuar në dëgjim publik apo të njëjtit i është dorëzuar Aktvendimi mbi eksproprijimin i cekur si më lartë. Pra, të drejtat ligjore të Palëve në mjete juridike rrjedhin nga momenti kur iu dorëzohet Aktvendimi mbi eksproprijimin dhe ato nuk rrjedhin gjatë kohës brenda të cilës Pala nuk ka qenë ose nuk ka mundur të jetë në dijeni gjegjësisht përderisa të njëjtës nuk i është dorëzuar një kopje e Aktvendimit.

Ndërsa lidhur me pretendimet e të Paditurës kishin qenë se me nenin 21 paragrafi 5 i Ligjit mbi Eksproprijimin parashihet se pasi që të kalojë afati prej 10 viteve nga koha kur vendimi mbi eksproprijimin të marrë formën e prerë nuk mund të kërkohet de eksproprijimi, Gjykata e vlerësoi se në rastin konkret ky pretendim nuk është i qëndrueshëm dhe i bazuar për arsyet si në vijim: në pikat e më sipërme të arsyetimit të kësaj Ankese faktua se pronari juridik F.....(B.....) O.... dhe Paditësit si shfrytëzues të patundshmërisë lëndore nuk ishin ftuar në procedurën e diskutimit publik dhe për këtë organi shpronësues Komuna e Prishtinës ka qenë e obliguar sipas Ligjit mbi eksproprijimin që ti ftojë në diskutim publik; e Paditura nuk i kishte de poseduar nga patundshmëria lëndore pronarin juridik F..... (B.....) O..... apo paraardhësin e Paditësve apo vetë Paditësit, e Paditura nuk kishte ofruar prova se pronarit juridik F..... (B.....) O..... apo paraardhësit të Paditësve dhe Paditësve ua kishte kompensuar patundshmërinë lëndore, aq më tepër kur e Paditura nuk e kishte ngritur një pretendim të tillë. E Paditura nuk paraqiti prova për

ta bindur Gjykatën se Aktvendimi mbi eksproprijimin i është dorëzuar çoftë pronarit juridik F..... (B.....) O..... apo poseduesve tani Paditësve, prandaj Aktvendimi mbi eksproprijimin nuk ka mundur të bëhet i formës së prerë dhe nuk kanë mundur të rrjedhin afatet për Palët të cilëve nuk iu ka dorëzuar kopja e Aktvendimit.

Si rezultat i të gjithë këtyre që u theksuan më lartë e Paditura Komuna e Prishtinës nuk e ka fituar të drejtën e pronësisë sipas Dispozitës së nenit 20 të Ligjit për marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore i cili Ligj përcakton se e drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe mënyrën e përcaktuar me Ligj. Duke pasur parasysh se e Paditura Komuna e Prishtinës nuk ka vepruar sipas ligjit mbi Eksproprijimin i cili Ligj parasheh detyrimisht kompensimin e pronës, kjo vërteton se nuk e ka zbatuar drejtë Ligjin dhe nuk janë plotësuar kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë sipas Ligjit. Ligji mbi eksproprijimin parasheh kompensimin e pasurisë së eksproprijuar që duhet ti paguhet pronarit dhe shfrytëzuesit të pronës për qëllimin e eksproprijimit gjë që Komuna e Prishtinës nuk e ka bërë një gjë të tillë. Në vijim do ti referohemi një praktike të Gjykatë Supreme të Republikës së Kosovës me Aktgjykimin e saj Rev.nr.50/2011 të datës 30.01.2011 e cila e ka pranuar revizionin e Paditësve dhe e ka ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut AC.nr.490/2010 datë 31.01.2011. Në rastin e sipër cituar ishte nxjerrë një Aktvendim mbi eksproprijimin nga Kuvendi Komunal në Podujevë në vitin 1980, kundër këtij Aktvendimi ishte paraqitur një Padi në vitin 2008 që do të thotë 28 vite pasi që ishte nxjerrë Aktvendimi mbi eksproprijimin. “Por, Gjykata Supreme e Kosovës në fagen 3 pasuesi i parafundit dhe i fundit kishte dhënë arsyetime të thukta ku kishte theksuar se në bazë të nenit 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike e drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe mënyrën e përcaktuar me Ligj, në rastin konkret fitimi i pronësisë nuk është bërë në kushtet e përcaktuara me ligj ngase e paditura nuk ka vepruar sipas Ligjit mbi eksproprijimin i cili detyrimisht e obligon që ta bëjë kompensimin e pronës së eksproprijuar i cili kompensim duhet ti bëhet pronarit dhe shfrytëzuesit”. Pra, edhe pse kishin kaluar 28 vite nga data e nxjerrjes së Aktvendimit mbi eksproprijimin Gjykata Supreme kishte mbajtur qëndrimin se kur vendimi mbi eksproprijimin është i kundërligjshëm ngase nuk është bërë pagesa për pasurinë e eksproprijuar atëherë nuk mund të konsiderohet se Komuna e ka fituar të drejtën e pronësisë sipas Ligjit. Pra, në rastin konkret kemi të bëjmë me një rast krejtësisht identik sikurse rasti kur ka vendosur Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin e saj Rev.nr.50/11, pra rasti është tipik, Ligji mbi eksproprijimin është i njejtë dhe në të dy rastet nuk është bërë pagesa për pasurinë e eksproprijuar. Prandaj Gjykata i pati dy arsye te forta që ti referohet këtij Aktgjykimi të Gjykatës Supreme, arsyeja e parë është se qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe Ligjit, prandaj është obligim i Gjykatave që për raste identike te vendosim në mënyrë identike dhe arsyeja e dytë është se Aktgjykimet e Gjykatës Supreme dhe qëndrimet e saj janë meritore dhe obligative për çdo Gjykatë ngase Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë në kuadër të Sistemit Gjyqësor të Kosovës prandaj edhe qëndrimet e Gjykatës Supreme duhet zbatuar nga Gjykatat e instancës më të ultë. Prandaj duke pasur parasysh qëndrimin e Gjykatës Supreme në Aktvendimin e saj të cekur me lartë Gjykata nuk i more për bazë pretendimet e përfaqësuesit të Paditurës se me nenin 21 alineja 5 të Ligjit mbi Eksproprijimin pasi që të kalojë afati prej 10 viteve nuk mund të kërkohet deeksproprijim.

Gjykata e vlerësoi edhe pretendimin e të Paditurës se e drejta e pronësisë me parashkrim fitues nuk mund të fitohet mbi pronën shoqërore ngase një gjë e tillë është në kundërshtim me nenin 29 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike. Për vlerësimin e Gjykatës ky pretendim nuk është i qëndrueshëm sepse me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike të vitit 1996 është shfuqizuar dispozita e nenit 29 e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike dhe është barazuar prona private me pronën shoqërore sa i përket mënyrës së fitimit të pronësisë me parashkrim fitues. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike ka hyrë në fuqi në vitin 1996 prandaj deri në vitin 2016 ka kaluar periudha prej 20 viteve kur ky Ligj ka hyrë në fuqi ndërsa periudha 20 vjeçare është afat ligjor për fitimin e së drejtës së pronësisë me parashkrim fitues. Për vlerësimin e Gjykatës ky pretendim ka vlejtur deri në vitin 2016, por pas vitit 2016 kur kanë kaluar 20 vite prej se është shfuqizuar neni 29 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike ky pretendim është i pabazuar në Ligj.

Gjykata nga kërkesa për deeksprijim me numër 010465/9479 e datës 22.04.2008 vërtetohet se 53 familje të Lagjes “Mati 1” kanë kërkuar de eksprijimin e patundshmërive të parashtruara si në kërkesë, por kërkesa për de eksprijim është një kërkesë e qytetarëve dhe nuk është akt juridik i cili do të provonte ndonjë rrethanë me rëndësi për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje juridike, prandaj Gjykata të njëjtën e vlerësoi si krejtësisht jo relevante.

I njëjti arsyetim vlen edhe në përgjigjen e lartcekur për konsultim paraprak e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, nuk është me rëndësi relevante për të vërtetuar ndonjë rrethanë me rëndësi përveç se kjo Ministri i ka udhëzuar parashtruesit e kërkesës që të drejtat e tyre ti realizojë në rrugë gjyqësore.

Nga procesverbali i vendit të ngjarjes shihet se kontesti ka të bëjë me pjesën e ngastrës kadastrale 2620-1 Z.K Prishtinë në të cilën pjesë sipas gjendjes faktike janë të evidentuara disa objekte të banimit individual me etazhitete dhe gaberitë të ndryshme të cilat do të caktohen pas matjeve gjeodezike. Pra Gjykata nga seanca e vend shikimit kishte kuptuar se Paditësit kishin ndërtuar objekte banimi individuale me etazhitete të ndryshe të cilat rezultojnë për bindjen e Gjykatës të jenë ndërtuar shumica prej tyre para se të nxirret Aktvendimi mbi eksprijimin gjegjësisht para vitit 1985. Gjykata vërtetoi se Paditësit ishin në posedim faktik qysh para vitit 1985 dhe kjo vërtetohet nga vjetërsia e objekteve të banimit dhe objekteve tjera përcjellëse. Pra, nga konstatimi i Gjykatës në seancën e vend shikimit u vërtetua se Aktvendimi mbi Eksprijimin nuk e kishte arritur qëllimin asnjëherë gjegjësisht nuk ishte ndërtuar asnjëherë projekti “Kodra e Diellit II”. Gjykata ishte bindur se Paditësit asnjëherë nuk ishin deposeduar nga patundshmëria lëndore, Gjykata ishte bindur se të njëjtit për me shumë se 40 vite Paditësit janë në posedim faktik dhe të pa ndërprere të patundshmërisë lëndore, po ashtu Gjykata ishte bindur se për pikën 2 të Dispozitivit të kërkesëpadsisë për të cilën është refuzuar kërkesëpadsia e Paditësve, kjo pjesë kishte qenë rrugë publike dhe atë rrugë nuk e shfrytëzonin vetëm Paditësit, por atë rrugë e shfrytëzonin edhe banorët tjerë të asaj lagje, prandaj Gjykata vendosi që pikën II të dispozitivit të Kërkesëpadsisë ta refuzonte si të pa bazuar.

Nga Ekspertiza e Gjeodezisë, Gjykata kishte identifikuar patundshmërinë lëndore me të gjitha detajet e nevojshme të cilat i kishte përshkruar Eksperti në Ekspertizën e tij, Gjykata kishte konstatuar për masat dhe kufijtë, gjegjësisht pikat të cilat i kishin në posedim secili nga Palët Padiëse prandaj edhe u bind se precizimi i Kërkesëpadiëse pas nxjerrjes së Ekspertizës së gjeodezisë ishte bërë në përputhej me konstatimin dhe vendimin e Ekspertit të Gjeodezisë. Nga konstatimi Ekspertit Gjeodezisë, Gjykata ishte bindur se pjesa e patundshmërisë lëndore e përshkruar si në pikën II të dispozitivit për të cilin Gjykata kishte refuzuar Kërkesëpadiën e Palës Padiëse, shërbente si rrugë publike, të cilën rrugë e shfrytëzonin edhe Padiësit por edhe qytetarët tjerë, prandaj Gjykata përveç në seancën e vend shikimit edhe përmes kësaj Ekspertize u bind se për pjesën e patundshmërisë lëndore që shërbente si rrugë publike ta refuzon Kërkesëpadiën e Palës Padiëse si të pa bazuar. Përmes seancës së vend shikimit, dhe përmes konstatimit dhe mendimit të Ekspertit të Gjeodezisë, Gjykata u bind se në pjesën e patundshmërisë të cilën e shfrytëzonte B..... S..... me sipërfaqe prej 200 m², B.....S.....kishte ndërtuar në këtë pjesë të ngastrës lëndore objektin e vendbanimit individual me etazhitet B+P+2, gaberiti i së cilës është 12.0m x 11.10m = 133.20m me një sipërfaqe të përafërt të banimit mbi 500 m² e që dukshëm vlera e objektit është me e madhe se sa vlera e tokës, nga seanca e vend shikimit dhe nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë Gjykata u bind se Padiësi M..... S.... kishte në shfrytëzim një sipërfaqe prej 249 m² në të cilën kishte të ndërtuar një objekt me dimensione 8.20m x 8.15m me dimensione 66.33 m², nga seanca e vend shikimit dhe nga Ekspertiza e Ekspertit të Gjeodezisë Gjykata kishte vërtetuar se E..... S..... kishte në shfrytëzim një sipërfaqe prej 249 m² dhe në të kishte të ndërtuar objekte banimi të përshkruara si në ekspertizë. Aq më tepër kur në bazë të matjeve aerofotogrametrike të vitit 1983 figurojnë objekti të cilin e ka në posedim Padiësi E..... S..... që për Gjykatën është me relevancë shume të madhe ky fakt sepse rezulton se Padiësi E..... S..... e ka pasur në posedim faktik patundshmërinë lëndore edhe përpara se të nxirret Aktvendimi mbi Eksproprijimin. Po ashtu edhe Padiësit tjerë H..... S....., R..... S..... kishin të ndërtuar shtëpi me etazhite të ndryshme dhe objekte tjera përcjellëse ashtu siç është përshkruar në ekspertizën e gjeodezisë. Rrethanë kryesore për Gjykatën për tu bindur se të gjithë Padiësit janë në posedim faktik të patundshmërive përpara se të nxirret Aktvendimi mbi eksproprijimin është fakti se të gjithë Padiësit janë vëllezër dhe të gjithë Padiësit janë fëmijët e tani të ndjerit S..... (H.....) S..... i cili i pari ishte vendosur në patundshmërinë lëndore dhe pastaj atë patundshmëri e kishin ndarë vëllezërit në mënyrën siç e ka përshkruar eksperti, por fakti që Eksperti ka konstatuar se objekti i ndërtuar është para vitit 1979 dhe kjo vërehet edhe nga matjet aerofotogrametrike të vitit 1983 për Gjykatën ka qenë vendimtare të bindet se Padiësit janë në posedim faktik të patundshmërisë lëndore para se të nxirret Aktvendimi mbi eksproprijimin. Gjykata ia fali në tërësi besimin Ekspertizës së Ekspertit të Gjeodezisë e cila ishte e pa kontestuar nga Palët në procedurë.

Nga certifikata e pronës 11942/03-0170982/20 vërtetohet se patundshmëria lëndore evidentohet si pasuri shoqërore Kuvendi Komunal në Prishtinë, rrethanë kjo e cila nuk ishte kontestuese, ndërsa nga fotografitë e vendit të ngjarjes shihet se në patundshmërinë lëndore janë të vendosura 6 objekte me gaberit të lartë dhe po thuajse e gjithë patundshmëria lëndore është e mbuluar me ndërtim, është e shfrytëzuar maksimalisht me përjashtim të një pjese të vogël që shërben si oborr apo hyrje, pra dendësia e objekteve e ndërtuar mbi këtë patundshmëri e fakton

se Paditësit e kanë në posedim faktik çdo pjesë të patundshmërisë për të cilën Gjykata e ka aprovuar Kërkesëpadinë e Palës Paditëse si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjendja faktike e vërtetuar nga Gjykata. –

Gjykata në pikat e me sipërme të arsyetimit të këtij Aktgjykimi i vlerësoi veç e veç dhe te gjitha se bashku dhe veçanërisht provave të cilave kjo Gjykatë ua fali besimin dhe atë: Aktvendimin mbi Eksproprijimin 07.nr.465-25/85 i datës 08.07.1985, Procesverbalin e vendit të ngjarjes, Ekspertizën e Gjeodezisë e datës 23.09.2020 dhe fotografitë nga vendi i ngjarjes ishin provat vendimtare në të cilat Gjykata e mbështeti Aktgjykimin e saj dhe për këto prova vendimtare Gjykata dha arsyetim të mjaftueshëm në pikat e lart cekura prandaj në këtë pjesë ta arsyetimit nuk do të përsërisim qëndrimet dhe vlerësimet e Gjykatës, por vetëm do të iu referohemi pikave të lartcekura të arsyetimit. Nga vlerësimi i përgjithshëm i provave Gjykata u bind se paraardhësi i Paditësve dhe Paditësit kanë qenë në posedim të patundshmërisë lëndore qysh nga viti 1979 kur e kanë ndërtuar shtëpinë e parë dhe këtë rrethanë Gjykata e vërteton përmes konstatimeve dhe mendimit të Ekspertit, i cili në Ekspertizën e tij ka konstatuar se në bazë të programit Bormen të vitit 1983 shtëpia ka qenë e ndërtuar para kësaj periudhe gjegjësisht ka qenë e ndërtuar përpara se të nxirret Aktvendimi mbi shpronësimin. Prandaj Paraardhësi i Paditësve dhe Paditësit kanë qenë shfrytëzues me mirëbesim të patundshmërisë lëndore në raport me pronarin e mëparshëm F..... (B.....) O..... përpara se të nxirret Aktvendimi mbi shpronësimin, fakti se ka qenë një shtëpi e ndërtuar qysh në vitin 1979 kishte rëndësi të shumëfishtë për Gjykatën dhe atë shtëpia është ndërtuar në një periudhë gati 42 vjeçare, e njëjta është ndërtuar përpara se të nxirret Aktvendimi mbi shpronësimin dhe prej kohës kur është ndërtuar e deri sot askush nuk i ka depozeduar ose penguar Paditësit në shfrytëzimin e patundshmërisë lëndore. Prandaj paditësit janë shfrytëzues me mirëbesim të patundshmërisë lëndore.

Nga Vendimi mbi eksproprijimin Gjykata dha arsyetim të thuktë në pikat e lartcekura dhe i vërtetoi se qëllimi i eksproprijimit nuk është arritur asnjëherë, Paditësit nuk janë de poseduar nga shfrytëzimi i patundshmërisë dhe çmimi për pasurinë e eksproprijuar nuk është paguar asnjëherë, prandaj bazuar në qëndrimin e Gjykatës Supreme të cekur si më lartë, Komuna e Prishtinës nuk ka arritur ta fitojë të drejtën e pronësisë konform nenit 20 të LMTHPJ-së ngase e njëjta nuk kishte vepruar sipas Ligjit mbi Eksproprijimin e pasurisë së patundshme, për të mos e ekzagjeruar këtë arsyetim mbetemi në tërësi pranë pikave të lartcekura të arsyetimit ku iu kemi referuar Aktvendimit mbi Eksproprijimin.

Meqenëse Paditësit kishin ndërtuar shtëpi banimi që nga viti 1979 dhe të njëjtët kishin qenë në mirëbesim që nga ajo kohe dhe se nuk ishin penguar nga askush, nuk ishin depozeduar asnjëherë, nuk ishin përfshirë në procedurën e eksproprijimit me Aktvendimin e lartcekur për vlerësimin e Gjykatës të njëjtit janë shfrytëzues me mirëbesim që nga viti 1979 e deri në ditën e sotme për një periudhë kohore prej 42 vitesh, pra Gjykata u bind se të njëjtit janë shfrytëzues me mirëbesim për 42 vite.

Për Gjykatën arsyetimi se nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë mbi pronën shoqërore me anë të parashkrimit fitues ka mundur të vlejë deri në vitin 2016 por jo edhe pas kësaj periudhe ngase në vitin 1996 me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Marrëdhënie Themelore Pronësore Juridike është shfuqizuar neni 29 i Ligjit dhe është barazuar prona shoqërore me pronën private sa i përket mënyrës se fitimit të pronësisë me parashkrim fitues prandaj nga viti 1996 deri në vitin 2021 kur është nxjerrë ky Aktgjykim kanë kaluar 25 vite ndërsa për tu fituar e drejta e pronësisë me parashkrim fitues sipas nenit 28 të LMTHPJ-së nevojitet periudha kohore prej 20 vitesh. Prandaj Gjykata vlerësoi se në këtë çështje juridike plotësohen në mënyrë komulative të 3 kushtet për fitimin e se drejtës se pronësisë me parashkrim fitues dhe atë mbajtja me mirëbesim e sendit i cili kusht plotësohet sepse mirëbesimi është fituar në raport me një person të tretë fizik e ai është F..... O....., kushti i dytë është mbajtja e ndërgjegjshme e sendit të patundshëm edhe ky kusht plotësohet sepse Padiësit kanë qenë mbajtës të ndërgjegjshëm të sendit të patundshëm për një periudhe prej 42 vitesh dhe për këtë periudhë nuk janë penguar nga askush as nga e Padiura, dhe kushti i tretë është kalimi i periudhës prej 20 viteve e në rastin konkret për vlerësimin e Gjykatës nga viti 1996 kur është nxjerrë plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Marrëdhënie Pronësore Juridike me të cilin është shfuqizuar neni 29 i LMTHPJ-së e deri me tani ka kaluar periudha prej gati 25 vitesh, prandaj është plotësuar edhe kushti i tretë për fitimin e të drejtës se pronësisë me parashkrim fitues komform nenit 28-të të LMTHPJ-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së, sipas të cilit: *Pala e cila e humb kontestimin tërësisht ka për detyrë që, palës kundërshtare dhe ndërhyrësit të saj, të ja kompensoj shpenzimet gjyqësore.* Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurës, i referohen shumës së precizuar si në pikën IV, të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshinë shpenzimet procedurale për një ekspertiza 150,00 Euro, për taksë gjyqësore për padi 25,00 Euro, përpilimin e padisë 416 euro, për përpilimin e një parashtrese 416.00 euro si dhe si dhe pesë seanca (5 x 810.00 euro) = 4050.00 euro, në shumë të përgjithshme prej 5,057.00 Euro.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se Aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkëlje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkëlje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, mirëpo sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore, për pasojë ka pasur edhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për pjesën e ndryshuar si në dispozitivin I të këtij Aktgjykimi. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e padiësve është tërësisht e pabazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet konform nenit 201 pika b) dhe d) të LPK-së, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vlerëson se paditësit nuk mund ta fitojnë të drejtën e pronësisë në bazë të punës juridike-kontratës, për arsye se e njëjta nuk është lidhur pranë organit kompetent që më pasaj të mund të regjistrohet ndryshimet në regjistrat kadastral në bazë të saj. Poa ashtu kontrata e shitblerjes e datës 17.05.1972 e lidhur ndërmjet F.... O..... në cilësi të shitësit dhe S..... S....., nuk përmban objektin kontraktues, nuk dihet se për cilën pronë palët kontraktuese kanë hyrë në raport juridik të pafromalizuar.

Pronësia mund të fitohet në dy mënyra: 1) mënyra derivative dhe 2) mënyra origjinere, ndërsa në rastin konkret nuk plotësohen kushtet e parapara në dispozitat ligjore.

Gjykata e Apelit vlerëson se padia, përkatësisht kërkesa e saj drejtuar ndaj të paditurës është e pa bazuar për arsyet që do të shtjellohen në vijim. Paditësit me të paditurën nuk ka të lidhur asnjë raport juridik, punë juridike për fitimin e të drejtës së pronësisë. Pronësia mund të fitohet në dy mënyra: 1) mënyra derivative dhe 2) mënyra origjinere, ndërsa në rastin konkret nuk plotësohen kushtet e parapara në dispozitat ligjore, përkatësisht nenin 20 dhe 28 LMTHJP. Fitimi i të drejtës së pronësisë nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës bëhet përmes procedurës administrative (përmes ankandit publik), apo përmes procedurës së privatizimit kur kemi barjtjen e të drejtave të pronësisë të ndërmarrjeve shoqërore në personat fizik apo juridik në shfrytëzim në kohëzgjatje prej 99 viteve. Paditësit dhe e paditura ndërmjet veti nuk kanë të lidhur asnjë raport juridik, apo punë juridike që ka për qëllim bartjen e të drejtës nga e paditura tek paditësit në parcelën kontetsuese.

Gjykata sa i përket fitimit të të drejtës së pronësisë përmes punës juridike, vlerëson se një pretendim i tillë nga ana e paditëses është i pa bazuar, për arsye se në rastin konkret nuk kemi punë të vlefshme juridike të lidhur nga paditësit dhe të paditurës për barjtjen e të drejtës së pronësisë, as ndërmjet paaradhësit të paditësve dhe F..... O..... Për të fituar të drejtën e pronësisë në bazë të punës juridike duhet të plotësohet kumulativisht dy kushte: lidhja e kontratës tek organi kompetent (Gjykata komunale, ndërsa tani tek noteri) dhe më pastaj regjistrimi i saj në regjistrat kadastral, ndërsa në rastin konkret nuk është plotësuar asnjëri prej tyre.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar edhe mënyrat e tjara të mundshme për fitimin e të drejtës së pronësisë, mirëpo as këto paditësit nuk i plotëson siç është parashkrimi fitues (usucapio) është titull i fitimit të pronësisë në mënyrë origjinere duke e mbajtur sendin në posedim për kohën e caktuar. Pra me kalimin e kohës poseduesi me mirëbesim bëhet pronar. Për fitimin e të drejtës me parashkrim fitues duhet të plotësohen tri kushte: posedimi i ligjshëm, mirëbesimi dhe kalimi kohës dhe në rastin konkret nuk plotësohen kumulativisht këto të tri këto kushte dhe se Gjykata i vërtetoi këto nga provat e elaboruara më lartë.

Si rrjedhojë, Gjykatës se Apelit, pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, përfshirë këtu raportin e ekspertit të gjeodezisë të datës 23.09.2020, i rezultoi se nuk ishte kontestues fakti se në bazë të dhënave me të cilat disponon Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Prishtinës, rezulton se që nga viti 1999 është e evidentuara në emër të Kuv. Komunal Prishtinë, pronë shoqërore, ndërsa para këtij viti nuk ka të dhëna, sepse të njëjta gjinden në Serbi.

Së paku që nga viti 1999 e tutje, si pronar të ngastrës kadastrale të cekur më lartë evidentohet si pasuri shoqërore në emër të të paditurës. Ky fakt vërtetohet edhe nga certifikatat e pronësisë, të cilat janë administruar si prova materiale nga gjykata e shkallës së parë dhe gjenden në shkresat e lëndës, në të cilat konstatohet se pronare e kësaj ngastrë të cekura si më lartë, është e paditura, si pasuri shoqërore. Në anën tjetër, referuar provave të propozuara nga pala paditëse përmes të cilave edhe ka pretenduar si u takon e drejta e pronësisë mbi ngastrën kontestuese në bazë të posedimit me mirëbesim, rezulton se të njëjtat nuk është bazë e vlefshme për të konstatuar se paditësit i takon e drejta e pronësisë mbi ngastrën kontestuese.

Në lidhje me këtë, arsyetimi i dhënë nga gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e atakuar se provave të cilave ua fali besimin janë: Aktvendimi mbi Eksproprijimin 07.nr.465-25/85 i datës 08.07.1985, procesverbali i vendit të ngjarjes, ekspertizës gjodezike të datës 23.09.2020 dhe fotografit nga vendi i ngjarjes, ishin provat vendimtare ku është mbështetur Aktgjykimi. Nga vlerësimi i këtyre provave, gjykata e shkallës së parë është bindur se paraardhësi i paditësve kanë qenë në posedim të paluajtshmërisë lëndore që nga viti 1979, kur e kanë ndërtuar shtëpinë e parë dhe kjo rrethanë është vërtetuar përmes mendimit të ekspertit, i cili ka theksuar se në bazë të programit Bormen të vitit 1983 shtëpia ka qenë e ndërtuar para kësaj periudhe, gjegjësisht ka qenë e ndërtuar para nxjerrjes së Aktvendimit mbi shpronësimin. Prandaj paraardhësi i paditësve dhe paditësit kanë qenë shfrytëzues me mirëbesim në raport me pronarin e mëparshëm Faik Osmani përpara se të nxirret Aktvendimi mbi shpronësimin, dhe se shtëpia është ndërtuar qysh në vitin 1979, para 42 viteve, ka vërtetuar faktin se ngastrën kontestuese paditësit e shfrytëzoj për 42 vite të pa panguar nga askush, nga gjykata e shkallës së dytë vlerësohet si plotësisht i paargumentuar në prova dhe fakte. Në rrethana të tilla, nga provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, nuk vlerësohen të mjaftueshme për të provuar faktin se paditësve i takon e drejta e pronësisë mbi ngastrën kontestuese, pasi që nuk janë në përputhje me provat materiale tjera, përkatësisht me Aktvendimin mbi shpronësimin.

Me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, gjykata e shkallës së dytë ka ardhur në përfundim se me asnjë provë të vetme këtu paditësit nuk e kanë provuar para gjykatës se e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi ngastrën kontestuese, përkatësisht në rastin konkret nuk janë përmbushur asnjëri prej kushteve apo bazave ligjore të parapara me nenin 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko–Pronësore (LMThJP-GZ RSFJ 6/80), ndërsa nuk janë plotësuar kushtet ligjore as nga neni 28 i këtij ligji (me parashkrim fitues), që paditësve ti njihet e drejta e pronësisë mbi ngastrën kontestuese. Kjo për faktin se nga provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, të cilat janë elaboruar më lartë (raporti i ekspertit të gjeodezisë etj), rezultoi se ngastra kadastrale, pronësinë e të cilës paditësit e kërkojnë me kërkesëpadi, në vazhdimësi nuk kanë qenë pronar paditësit apo paraardhësi i tyre dhe se së paku që nga viti 1999 e njejtë është e evidentuara si pronësi në emër të paditurës.

Si rrjedhojë, baza juridike e kërkesëpadisë së paditësve nuk është provuar dhe arsyetuar fare nga pala paditëse, përmes provave materiale konkrete, si rezultat i së cilave edhe ka rezultuar se kërkesëpadija e tij është e pathemeltë.

Në anën tjetër, edhe nëse paditësi do të provonte faktin se ngastrën kontestuese e ka në posedim më shumë se 20 vite, kjo nuk do të provonte automatikisht faktin se i njëjti e ka fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues, ashtu siç e parasheh neni 28 parag.4 i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (LMTHJP), meqenëse gjykata nuk lidhet për bazën juridike të padisë konform nenit 253.2 të LPK-së. Kjo për faktin se me nenin 29 të LMTHJP-së, parashihet se në pronë shoqërore nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues. Edhe pse me ndryshimet e mëvonshme të LMThJP-së të vitit 1996, neni në fjalë rezultoi të jetë i fshirë, gjykata vlerëson se bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi, respektivisht Rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/59 për Ndryshimin e Rregullores nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë, në rastin konkret zbatohet LMThJP, i cili ka qenë në fuqi me 22.03.1989, e jo edhe ndryshimet e mëvonshme të tij (edhe nëse eventualisht do të zbatoheshin ndryshimet e ligjit të cekur më lartë, sërish nuk do të plotësoheshin kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, pasi që nga viti 1996 e deri sa ka qenë në fuqi LMTHJP deri me datën 20.08.2009, ku më pastaj është në fuqi Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore Nr.03/L-154, nuk ka kaluar afati 20 vjeçar. LPDTS në nenin 1.5 të tij përcakton *“Dispozitat e këtij ligji nuk aplikohen në të drejtat sendore publike ose vlerat pasurore të përbashkëta të cilat rregullohen me ligje të veçanta, përveç nëse në mënyrë specifike parashihet ndryshe me këtë ligj”*, pra nga interpretimi i kësaj dispozite shihet se ky ligj rregullon pronën private, krijimin, përmbajtjen, mbrojtjen dhe shuarjen e të drejtave sendore, ndërsa në pronat publike dhe shoqërore nuk aplikohet. Paditësit dhe paraardhësi i tyre, me asnjë provë nuk ka provuar faktin se ndonjëherë ka qenë i regjistruar si pronari parcelës kontestuese.

Si rezultat i kësaj, edhe nëse do të qëndronte pretendimi i paditësit në padi, se pa ndonjë bazë të vlefshme juridike e paditura e ka bartur të drejtën e pronësisë mbi ngastrën kontestuese, atëherë bazuar në nenin 226 të Ligjit të Punës së Bashkuar (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 53/76), Ligjit për Plotësimin e Ligjit të Punës së Bashkuar (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 57/83) dhe Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit të Punës së Bashkuar (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 85/87, ku parashihet se *“në qoftë se patundshmëria kalon në pronësi shoqërore pa bazë të vlefshme juridike, pronari e humb të drejtën e pronësisë, në qoftë se nuk e kërkon kthimin e pronësisë në afat prej 5 vjetësh, nga data e marrjes në dijeni, e më së largu në afat prej 10 vitësh”*. Kështu që edhe në bazë të këtyre dispozitave, rezultoi se edhe nëse do të provohej fakti se e paditura është bërë pronare e ngastrave kontestuese pa ndonjë bazë të vlefshme juridike, paditësit nuk do të mund ta fitonin të drejtën e pronësisë mbi to, për shkak të kalimit të afatit ligjor prej 10 vitësh për të parashtruar padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë (pasi që është provuar fakti se e paditura është e evidentuar si pronare e këtyre ngastrave së paku që nga viti 1999, ndërsa padia nga paditësit është parashtruar në gjykatë në vitin 2013, që do të thotë pas kalimit të 13 viteve). Sigurisht se dispozitat e cekura më lartë do të zbatoheshin në rast se do të provohej se me të vërtetë këtu paditësve i është marrë drejta e pronësisë pa bazë ligjore nga e paditura.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes rezultoi se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, me rastin e marrjes së Aktgjykimit të atakuar, për arsye se është provuar fakti se në rastin e paditësve nuk plotësohen kushtet ligjore nga neni 20 i LMTHJP-së për të konstatuar se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi ngastrën kontestuese të cekura si në dispozitivit të këtij aktgjykimi, të evidentuara si pronë shoqërore në emër të të paditurës.

Meqenëse nga të cekurat më lartë, ka rezultuar se padia dhe kërkesëpadia e paditësve është tërësisht e pabazuar në ligj dhe fakte, atëherë gjykata e shkallës së dytë u desht që të ndryshojë aktgjykimin e atakuar dhe të refuzojë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Përfundimisht e drejta e pronësisë në pronën shoqërore nuk mund të fitohet përmes institutit për parashkrimin fitues, në të njëjtën mund të fitohen të drejta sendore vetëm përmes punës së vlefshme juridike (ankadit publik, privatizimit), dhe për këto arsye është vendosur si në dispozitivin I të këtij Aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket vendosjes si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë. Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësve për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe i përmbarueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë.

Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit, për pjesën e vërtetuar si në dispozitivin II të këtij Aktgjykimi. Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, të cilat i pranon edhe Gjykata e Apelit, ngase ky vlerësim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe profesional, prandaj pretendimet ankimore të paditësit edhe në këtë drejtim tregohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e paditësve mbi këtë bazë, nuk qëndrojnë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese të cekura si në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t'i përsërisë edhe njëherë të gjitha, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Mënyrat e fitimit të të drejtës së pronësisë të pretenduar nga paditësit janë elaboruar më lartë dhe si përfundim paditësit nuk mund të fitojnë të drejtën e pronësisë në bazë të punës juridike, sepse e njëjta nuk është lidhur konform dispozitave ligjore që më pastaj të mund të

regjistrohet e drejta e pronësië në kadastër, e njeta nuk përmban objektin e shitblerjes dhe nuk dihet se për çka janë marrë vesh palët kontraktuese, po ashtu as me parashkrim fitues paditësit nuk mund ta fitojnë të drejtën e pronësisë në pronën shoqërore, edhe sikur e drejta pozitive të mundësonte fitimin e të drejtës së pronësisë në pronën shoqërore nuk ka kaluar afati prej 20 viteve nga ndryshimet e vitit 1996 e deri në aplikimin e LMTHJP, edhe nëse ky ligj ish aplikuar edhe më tutje prapë nuk kemi kalim të afatit prej 20 viteve sepse paditësi ka ushtruar padi me datë 10.10.2013 dhe në momentin e parashtrimit të padisë ndalet afati i parashkrimit dhe posedimit me mirëbesim, përkatësisht periudha pas ngritjes së padisë nuk mund të konsideron posedim me mirëbesim, me arsyetim se paditësit llogaritet së paku nga ngritja e padisë kanë marrë dijeni se prona nuk është e tyre.

Me rastin e shqyrtimit të ankesave të palëve ndërgjyqëse, Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ankuuese, mirëpo të njëjtat, nuk patën ndikim në marrjen e një vendimi ndryshe nga ky që është marrë.

Lidhur me pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi konform nenit 450 të LPK-së, që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, nga të lartcekurat, e në mbështetje të nenit 195 paragraf. 1 pika d dhe e), e lidhur me nenin 201 pika b) dhe d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.9300/2021, datë 15.04.2024

Kryetari i kolegjit,
Ardian Ajvazi